



**KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"**  
**COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA"**  
Prishtinë

Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-ks.com>

---

**Seminari akademik**  
**Si të shkruhet një seminar akademik**

**Manual për përgatitjen e seminareve akademike**

**Definimi:**

Sipas Rregullores së studimeve të Kolegjit të Shkencave Mjekësore, nenit 27

Seminari paraqet formë mësimore në të cilën studentët, nën mbikëqyrje të mësimitdhënësit përpunojnë në mënyrë aktive materialin mësimor, të përgatitur që më parë.

**Qëllimi i seminarit:**

është që studenti të studiojë më thellë disa tema të caktuara, të njoftohet me mënyrat e studimit dhe të konkludimit.

Gjatë mbrojtjes së seminareve facilitatori parashtron pyetje me të cilat orienton angazhimin e studentëve drejt nxjerrjes së konkluzioneve lidhur me temën e shtjelluar si dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga studentët. Seminari vlerësohet si pjesë e vlerësimit dinamik të studentit dhe merr pjesë në strukturë të caktuar në notën përfundimtare.

Pjesëmarrja e seminarit në notën përfundimtare përcaktohet në planprogramin e lëndës.

**Struktura e seminarit**

Struktura e seminarit është e ngjashme me strukturën e një eseut kërkimor  
Seminari ka këto pjesë:

**1. Faqja e titullit – duhet të përmbajë këto informata:**

- stemën e institucionit
- Racionalet e prezantimit: Seminar akademik
- Tema: Titulli i seminarit akademik (topic)

- Drejtuar: Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca" – Departamentit të \_\_\_\_\_
- Emri i studentit/ëve
- Emaili i studentit
- Emri i mbikqyrësit të punimit
- Data e dorëzimit:

Forma e faqes së titullit (shembull)



**KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"**  
**COLLEGE OF MEDICAL SCIENCES "REZONANCA"**  
Prishtinë

Seminar akademik

Titulli i seminarit akademik

Drejtuar:  
Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca"  
Departamentit të \_\_\_\_\_

Emri dhe mbiemri i studentit

Emaili i studentit

Emri i mbikqyrësit të punimit:  
Prof. dr. Xxxxx Xxxxxxxx

Data e dorëzimit:  
01.01.2021

## 2. Hyrja

- Ka për qëllim të njoftojë audiencën lidhur me problematikën e temës së punimit, ta kufizojë temën e seminarit dhe të ngjallë interesimin për ta dëgjuar deri në fund.
- Hyrja duhet të shërbejë si "tregues i rrugës" në të cilën drejtohet prezantimi juaj
- Hyrja mund të jetë e drejtpërdrejtë - kur bëhet hyrja e drejtë në temë; është shumë informuese dhe zakonisht mjaft e shkurtër (p.sh. Qëllimi i seminarit tim është të .....],
- ose jo e drejtpërdrejtë - me përdorim të metodës deduktive, kur procesi kalon nga informacioni shumë i përgjithshëm në informacion më të veçantë, ose të metodës induktive (kalimi nga e veçanta në të përgjithshme], ose me përdorimin e citimeve, krahasimit, përdorimit të ndonjë shembulli, prezantimit të një problematike shkencore, etj.

## 3. Pjesa kryesore (trupi - body)

- Përfshinë analizën e temës së seminarit. Në këtë pjesë studenti paraqet shtjellimin e qëllimeve kryesore të seminarit, prezanton shembujt, shpalosë evidencat e gjetura lidhur me çështjen, etj.
- Informatat në këtë pjesë të seminarit duhet të jenë mirë të strukturuar, të bazuara në një sistem të organizuar paraprakisht nga studenti. Mund të jetë me renditje kronologjike, me renditje sipas temave (çështjeve] ose sipas rëndësisë së çështjeve
- Theksoni informatat me rëndësi
- njoftoni audiencën kur informata është me rëndësi të veçantë ose me interes si dhe tregoni arsyet përse.

## 4. Konkluzionet

- Përmbledhje e shkurtër e qëllimeve kryesore të përfshira në pjesën kryesore të seminarit.
- Shpallen përsëri qëllimet kryesore të seminarit
- Ri-përgjigjen pyetjet kryesore
- Mos prezantoni ndonjë informatë të re në konkluzione
- Shfrytëzoni rastin për t'i treguar audiencës se ju keni shtjelluar të gjitha çështjet kryesore të përcaktuara në hyrjen e seminarit

## 5. Apendiksi (Shtojca)

- Është pjesë opcionale.
- Këtu mund të paraqitni materialin shtesë të rëndësishëm për mbështetjet të qëllimeve kryesore të seminarit (p.sh. mund të paraqitni teskte të veçanta, tabela ose figura të mëdha të rëndësishme për temën, argumentimet e zgjeruara, etj.]

## 6. Bibliografia

- Çdo literaturë e cituar duhet të paraqitet në bibliografi, ashtu që të gjitha referencat e prezantuara në bibliografi duhet të jenë të cituara diku në tekstin e seminarit.

Citimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose indirekt.

Citation drejtpërdrejtë i fjalive të marra nga literatura në mënyrë origjinale paraqet një citim të drejtpërdrejtë. Përdorni citim të drejtpërdrejtë me masë. Nëse përdoret citimi i drejtpërdrejtë, teksti i kopjuar duhet të jetë i mbyllur me thonjëza (" "), në fillim dhe në fund. Nëse kopjoni vetëm një paragraf, ose vetëm një pjesë të tekstit, pjesën që hiqet e paraqesim me tri pika në vazhdimësi (...).

Citimi është indirekt nëse teksti ndryshohet duke përdorur fjalitë e veta për të treguar atë që e ka paraqitur autori në artikullin ose publikimin origjinal. Ky tekst nuk vendoset ndërmjet thonjzave.

**Referencat (regjistri i literaturës)** shkruhen në fund të punimit. Autorët (referencat), të cilët përmenden me shifra arabe në kllapa në tekstin e punimit, me font dhe madhësi të njëjtë sikurse edhe teksti tjetër, në regjister të literaturës radhiten sikurse janë përmendur në tekst. Shënohet numri rendor arab, pastaj të gjithë autorët e referencës, përveç nëse janë më shumë se 6 autorë, kur do të shkruhen 3 autorët e parë me shkurtesën **e b.p.** (që d.t.th.: e bashkëpunëtorë). Pika nuk përdoret pas inicialeve të emrave të autorëve. Shkurtesat për revista shënohen sipas regjistrin në Index Medicus, Journal Indexed for MEDLINE, të publikuar nga NLM në Library's Web site.

Citimi i Web dokumentave duhet të përfshijë edhe datën e qasjes në këto burime.

Referencat në punimet e pranuar por ende të pabotuara duhet të shënohen "në shtyp" ("in press"), kurse autori duhet të sigurojë lejen me shkrim për citimin e këtij punimi, sikurse edhe verifikimin se punimi është pranuar për publikim.

Shembuj të stilit të shënimit të referencave:

1.Revista	
<b>Cross D, Burmester J.</b>	Autori/[t
<a href="#"><u>Gene Therapy for Cancer Treatment: Past, Present and Future.</u></a>	titulli
<b>Clin Med Res.</b>	emri i revistës
<b>2006 September;</b>	viti
<b>4(3):</b>	vëllimi (numri)
<b>218–27.</b>	faqet

1. **Cross D, Burmester J. [Gene Therapy for Cancer Treatment: Past, Present and Future.](#) Clin Med Res. 2006 September; 4(3): 218–227.**

2. Suplementi i revistës	
Wayet JI, Rathbone BJ.	Autori (autorët)
Immune response of the gastric mucosa to Compylbacteri pylori.	titulli
Scan J Gastroenterol	emri i revistës
2010;	viti

23 (suppl.142):	numri
44-9.	faqet

2. Wayet JI, Rathbone BJ. Immune response of the gastric mucosa to *Compylbacteri pylori*. *Scan J Gastroenterol* 2010; 23 (suppl.142): 44-9.

### 3.Libri (monografia)

Mark EJ.	autori
Lung biopsy interpretation.	titulli i veprës
Baltimore:	vendi i botimit
Williams&Wilkins,	botuesi
2009:	viti i botimit
31-2, 94-102.	faqet

3. Mark EJ. Lung biopsy interpretation. Baltimore: Williams&Wilkins, 2009: 31-2, 94-102.

### 4. Kapitulli i librit

Schielber GL.	autori
Diseases of tricuspid valve.	titulli i punimit
In (në): Moss AJ, Adams F, eds.(red.)	
Heart diseases in infants, children and adolescents.	titulli i librit
Baltimore:	vendi i botimit
Williams&Wilkins,	botuesi
2011:	viti i botimit
134-9.	faqet

4. Schielber GL. Diseases of tricuspid valve. In (në): Moss AJ, Adams F, eds.(red.) Heart diseases in infants, children and adolescents. Baltimore: Williams&Wilkins, 2011: 134-9.

### 5.Përmbledhja e punimeve

Disha M.	autori
Veprimet anësore dhe toksike të barnave.	titulli i punimit
Përmbledhje të referatve dhe të rezymeve të takimit	
IV profesional të Mjekëve të Kosovës.	titulli i përmbledhjes
Prishtinë:	vendi
2014;	viti
29-32.	faqet

5. Disha M. Veprimet anësore dhe toksike të barnave. Përmbledhje të referatve dhe të rezymeve të takimit IV profesional të Mjekëve të Kosovës. Prishtinë: 2014; 29-32.

### 6.Grupi i autorëve (autori kolektiv)

Multicenter Postinfarction Research Group	institucioni-grupi i autorëve
Risk stratification and survival after myocardial infarction.	titulli
N Engl J Med	emri i revistës(botuesit)
2013;	viti i botimit
309:	numri
331-6.	faqet

6. Multicenter Postinfarction Research Group. Risk stratification and survival after myocardial infarction. *N Engl J Med* 2013; 309: 331-6.

### 7.Artikulli anonim

	Artikull anonim
Coffe drinking and Cancer of pancreas.	titulli
Br Med J	revista
2008;	viti i botimit
283:	vëllimi
626. faqja	

7. Coffe drinking and Cancer of pancreas. Br Med J 2008; 283: 626.

8.Gazeta	
Latifi H.	autori
Tuberkulozi në Kosovë në periudhënjëtar tetor.	titulli
Bujku	emri i gazetës
1994 (20 dhjetor);	viti, data, muaji
1041:	numri
6.	faqja

8. Latifi H. Tuberkulozi në Kosovë në periudhënjëtar tetor. Bujku 1994 (20 dhjetor); 1041: 6.

9.Disertacioni i doktoratës (teza e magjistraturës)	
Cairns RB.	autori
Infrared spectroscopic studies of solid oxygen. (disertacion)	titulli
Berleley, California:	vendi
University of California, 2010,	Universiteti (fakulteti) viti
faqe 156.	faqja

9. Cairns RB. Infrared spectroscopic studies of solid oxygen. (disertacion) Berleley, California: University of California, 2010, faqe 156.

#### Raporte, burime nga Interneti, etj.

10. National Library of Medicine. Medical informatics. Bethesda, MD: National Institutes of Health; 1986 Dec; p. 16–25. (National Library of Medicine Long Range Plan, Report of Panel 4.)

11. Medical Library Association. MLANET [Internet]. Chicago, IL: The Association; 1996 ërev. 1 Jan 2008; cited 24 Jan 2008]. <<http://www.mlanet.org>>.

12. Joint Commission. “What did the doctor say?”: improving health literacy to protect patient safety [Internet]. The Commission; 7 Feb 2007 [cited 8 Feb 2007]. [http://www.jointcommission.org/NR/rdonlyres/D5248B2E-E7E6-4121-8874-99C7B4888301/0/improving\\_health\\_literacy.pdf](http://www.jointcommission.org/NR/rdonlyres/D5248B2E-E7E6-4121-8874-99C7B4888301/0/improving_health_literacy.pdf)>.

13. Virginia Commonwealth University Health System. About us [Internet]. The System [11 Apr 2007]. <<http://www.vcuhealth.org/?id=5&sid=1>>.

14. Dickerson S, Reinhart AM, Feeley TH, Bidani R, Rich E, Garg VK, Hershey CO. Patient Internet use for health information at three urban primary care clinics. J Am Med Inform Assoc. 2004 Nov–Dec;11(6):499–504. DOI: 10.1197/jamia.M1460.

## Aspektet formale

1. Udhëzime tipografike – për shtypjen e seminarit në letër

Fonti: Times New Roman,  
Madhësia: 11 pt  
Rrallori: 1.5  
Margjinat: majtas 3 cm, djathtas 2 cm, lartë 2 cm, poshtë 2 cm  
Fusnotat: rrallori 1, 10 pt

Formulat , simbolet matematikore, formulat kimike, etj., gjenerohen me Editorin e Ekuacioneve, përkatësisht me Editorin e formulave kimike dhe prezantohen si të tëra në apendiks.

### Ilustrimet

Çdo ilustrim duhet të ketë titullin, pjesën tekstuale, shënimet ose shpjegimet, të gjitha në gjuhën angleze. Shpjegimet (legjenda) shënohen në ilustrim. Marrja dhe riprodhimi i ilustrimeve nga autorë të tjerë, duhet të bëhet me lejen e botuesit dhe të autorit. Në tekstin e punimit autori vendosë ilustrimet përkatëse. Ilustrimet duhet kufizuar në numër të arsyeshëm, meqë këto e shtrenjtojnë botimin. Titulli, i shkruar në krye të ilustrimit, duhet të jetë konciz dhe përmbajtësor, ashtu që lexuesi ta ketë të qartë për çka është fjala.

**Tabelat** dhe **grafikonët** duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme lehtë, jo të komplikuar dhe të stërngarkuara me të dhëna. Shkurtesat e përdorura (shifrat romake, shkronjat e mëdha, ose shenjat e tjera) shpjegohen nën ilustrim, të renditura si fusnota.

## 2. Ortografia

Zbatoni të gjitha rregullat ortografike efektive gjatë shkrimit të tekstit.

Kontrolloni tekstin për evitimin e gabimeve gramatikore.

Për termet në gjuhën angleze konsultoni The Oxford English Dictionary.

## 3. Prezantimi

Prezantimi i seminarit bëhet në kohëzgjatje prej 15-20 min.

### Informatat e përgjithshme

- Prezantimi përgatitet në Power Point
- Para fillimit të prezantimit prezantoni vetvet audiencës (edhe pse ata veç ju njohin!)
- Respektone kohën e dhënë për prezantim
- Mos i mbingarkoni sllajdet me informata

- Respektone rregullën e "gjashqës": që d.t.th. 6 rreshta në një sllajd' çdo rresht me maksimalisht 6 fjalë; nëse rreshti plotësohet me maksimumin 6 fjalë, atëherë rreshti i fundit hiqet nga sllajdi dhe mbetet sllajdi me 5 rreshta.
- Çdo sllajd duhet të prezantohet diku për afërsisht për 1-2 min.
- Kufizonu në 1-2 madhësi të fontës dhe në vetëm një lloj të fontës
- Madhësia e fontës duhet të jetë aq sa mundëson që sllajdi të lexohet nga rreshti i fundit i sallës ku bëhet prezantimi
- Theksoni faktet më të rëndësishme
- Efektet e animacionit përdorni sa më rrallë dhe vetëm kur është e përshtatshme
- Siguroni versionin e shtypur (handout) për audiencën